



**BALKAN
MONITORING
PUBLIC
FINANCES**

www.wings-of-hope.ba

BIARN
BALKAN INVESTIGATIVE
REPORTING NETWORK



This project is funded
by the European Union

UDHËZIME PËR THIRRJEN PËR PROPOZIME PËR ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE/ORGANIZATAT JOQEVERITARE NË FUSHËN E FINANCEVE PUBLIKE

Monitorimi Ballkanik i Financave Publike shpall thirrjen për propozime brenda programit të Komisionit Evropian MBËSHTETJA PËR NISMAT E SHOQËRISË CIVILE DHE MEDIAS 2014-2015: Mbështet rrjetet regjionale tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile – “OSHC si partner të barabartë në monitorimin e financave publike”

KODI i projektit: IPA 2015/370-293

Afati për dorëzimin e aplikacioneve: **E enjte, 1 nëntor, ora 12.**

Qëllimi i këtyre udhëzimeve është që të sigurojë udhëzime të qarta dhe koncize për të gjithë aplikantët potencialë dhe subjektet e interesuara të procesit të dorëzimit të projekt propozimeve në përputhje me kornizën e thirrjes publike për organizatat joqeveritare / organizatat e shoqërisë civile.





**BALKAN
MONITORING
PUBLIC
FINANCES**

www.wings-of-hope.ba

BIIRN
BALKAN INVESTIGATIVE
REPORTING NETWORK



This project is funded
by the European Union

1. Sfondi dhe përshkrimi i aktiviteteve

Në vendet e targetuara:

- financat publike nuk janë transparente,
- impakti mbi adoptimin e politikave dhe vendimeve lidhur me financat publike nuk është mjaftueshëm i fortë,
- pjesëmarrja e OSHC-ve në monitorimin e financave publike dhe bërje të politikave është e varfër,
- numri i studimeve të pavarura është i ulët
- gazetaria hulumtuese është gati joekzistente,
- të kuptuarit dhe interesimi për financa publike në mesin e publikut të gjerë është mjaft i ulët.

Prandaj, është e ditur që:

- ka një nevojë në rritje për monitorim sistematik të financave publike dhe institucioneve publike,
- është e nevojshme të rritet kapaciteti i (OSHC-ve) për të ndikuar në adoptimin e politikave dhe vendimeve lidhur me financat publike,
- financat publike duhet të sillen më afër qytetarëve sepse njohuritë e tanishme për financat publike në mesin e publikut të gjerë janë mjaft të ulëta.

2. Objektivi i përgjithshëm për projekt propozime

Objektivi në thirrjen për dorëzimin e një projekt propozimi është që të kontribuon në krijimin e politikave të përgjegjshme dhe transparente dhe procese vendim marrëse në sferën e financave publike në fushën ambientit.

Objektivi i përgjithshëm i thirrjes

Kjo është një mundësi për t'i ftuar organizatat e shoqërisë civile (OSHC)/organizatat joqeveritare (OJQ) nga Balkani Përendimor (Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia) të dorëzojnë projekt propozime lidhur me qëllimet zhvillimore të projektit: “OSHC-të janë partnerë të barabartë në monitorimin e financave publike” dhe objektivat e tij specifike:

- të fuqizohen OSHC-të në forcimin e njohurive në fushën e financave publike, monitorim të financave publike, ofrojnë propozime të politikave dhe të marrin pjesë në procese politike, rrisin vetëdijen publike, lehtësojnë diskutimin me akterët politikë dhe hisedarët tjerë relevantë, komunikojnë dhe avokojnë për transparencë dhe përgjegjshmëri më të madhe në fushën e financave publike;



- mbështet median që të komunikojë dhe informojë publikun mbi problem apo procese politike të lidhura me financat publike;
- inkurajon ekspertë për të realizuar hulumtime dhe studime mbi tema specifike lidhur me financat publike;
- krijon platformë bashkëpunimi apo rrjete mbështetëse në mes të hisedarëve të ndryshëm për të krijuar vendimmarrje dhe politika transparente dhe të përgjegjshme në fushën e financave publike.

Kjo thirrje për propozime në mënyrë të qartë fokusohet në katër tema të përgjithshme të financave publike siç është borxhi publik, partneriteti publiko-privat, drejtësia tatimore dhe infrastruktura publike. Fondet do të alokohen tek ato organizata të shoqërisë civile projektet e të cilave kontribuojnë në zgjidhjen e një apo më tepër prioriteteve dhe i përmbushin kriteret e cilësisë dhe kushte tjera.

3. Fondet (grantet) në dispozicion për projekte

Projektet e pranueshme për këtë thirrje janë ato të cilat kërkojnë buxhet nga 4.000 EUR deri në 8.000 EUR. Projekti BMPF rezervon të drejtën që të mos dhurojë të gjitha fondet në dispozicion në rast se projekt propozimet nuk i përmbushin kriteret e caktuara. Fondet në dispozicion për këtë thirrje janë 45.600 EUR për vend.

OSHC-të e interesuara duhet të bashkëfinancojnë projektet e tyre apo të sigurojnë një pjesë të fondeve nga donatorë të tjerë. **Pritet që së paku 10% dhe maksimumi 50% e fondeve të përputhshme të jetë nga donatorë të tjerë.**

Grantet e ndara brenda kësaj thirrje mund të financojnë shpenzime administrative dhe shpenzime të stafit në një maksimum prej 40% të shumës së kërkuar. Fondet e mbetura prej 60% duhet të parashihen për aktivitete të programit të projektit.

3.1. Pranueshmëria e shpenzimeve: shpenzimet të cilat mund të merren parasysh për grant

Vetëm "shpenzimet e pranueshme" mund të konsiderohen për një grant. Kategoritë e shpenzimeve të konsideruara si të pranueshme dhe të papranueshme janë të paraqitura më poshtë. Buxheti është edhe një shpenzim i vlerësuar dhe një tavan për "shpenzime të pranueshme". Vini re se shpenzimet e pranueshme duhet të bazohen në kosto reale bazuar në dokumente mbështetëse.

Rekomandimet për dhënien e një granti janë gjithmonë të kushtëzuara me procesin e kontrollit para nënshkrimit të kontratës dhe nëse është zbuluar ndonjë problem që kërkon ndryshime në buxhet (për shembull gabime aritmetikore, pasaktësi ose kosto joreale dhe kosto të tjera të papranueshme). Kontrollat mund të krijojnë kërkesa për sqarime dhe të bëjë që projekti BMPF të bëjë modifikime ose reduktime për adresimin e gabimeve ose pasaktësive të tilla. Shuma e grantit dhe përqindja e bashkëfinancimit të BE-së si rezultat i këtyre korrigjimeve nuk mund të rritet.

Prandaj, është në interes të aplikantit të paraqes një buxhet **real dhe kosto-efektiv**.

Kostot direkte të pranueshme

Për të qenë të pranueshme nën këtë Thirrje për Propozime, kostot duhet të përputhen me dispozitat e Nenit 14 të kushteve të Përgjithshme të BE të aplikueshme për kontratat e granteve të financuara nga Bashkimi Evropian për projekte të jashtme.

Vini re se taksat, duke përfshirë, duke përfshirë TVSH-në do të pranohen si shpenzime të pranueshme vetëm kur të plotësohen kushtet si vijon:

- i. Taksa mbi vlerën e shtuar nuk rimbursohet në asnjë mënyrë;
- ii. Vërtetohet se ato janë mbartur nga përfituesi final; dhe
- iii. Ato janë prezantuar qartë në projekt propozim.

Kontributet në natyrë

Kontributet në natyrë nuk konsiderohen si shpenzime reale dhe nuk janë shpenzime të pranueshme. Kontributet në natyrë nuk mund të trajtohen si bashkë financim. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse përshkrimi i projektit i propozuar nga OSHC-ja Udhëheqëse dhe partnerët e saj parashikojnë kontribute në natyrë, kontributet e tilla duhet të sigurohen.

Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet vijuese nuk janë të pranueshme:

- tatimet, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (përveç nëse kushtet e caktuara nën Shpenzimet e Pranueshme Direkte janë plotësuar);
- detyrimet doganore dhe të importit, ose ndonjë tarifë tjetër;
- blerja, marrja me qira ose shfrytëzim e tokës dhe ndërtesave ekzistuese;

- gjohat, dënimet financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor;
- kostot operative;
- pajisjet e përdorura;
- shpenzimet bankare, shpenzimet e sigurimeve dhe shpenzime të ngjashme;
- kostot e konvertimit, pagesat dhe humbjet e këmbimit të çfarëdo komponente specifike të llogarive në euro, gjithashtu edhe shpenzimet thjeshtë financiare;
- kontributet në natyrë;
- çfarëdo shpenzimi qerasë;
- kostot e amortizimit;
- borxhet dhe pagesat e borxhit;
- provizionet për humbjet ose detyrimet potenciale të ardhshme;
- interesi i detyruar;
- kostot e deklaruara nga përfituesi dhe të mbuluara nga një aktivitet tjetër ose program pune;
- kreditë për palët e treta.

4. Informacion i përgjithshëm mbi thirrjen për projekt propozime

Dokumentacioni i projektit duhet të përmbajë si vijon:

- Projekt propozimin (Formati në Word - Aneksi 1),
- Formularin e buxhetit (Formati në Excel - Aneksi 2).

Dokumentacioni shtesë është pjesë shumë e rëndësishme e projektit dhe duhet të dorëzohet në tërësinë e tij me qëllim që projekt propozimi të vlerësohet. Dokumentacioni shtesë duhet të përmban si vijon:

- Kopje valide të certifikatës së regjistrimit të një organizate në Ballkanin Perëndimor (Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi). (për poseduesin e projektit/aplikantin dhe partnerët e projektit, në se ka),
- Kopje të statutit të organizatës (aplikanti dhe partnerët, nëse ka),
- CV-të e personave të angazhuar në projekt,
- Kopjen e plotësuar të formës së Identifikimit Administrativ (Formati në Word – Aneksi 4),
- Kopjen e plotësuar të formës së Identifikimit Financiar (Formati në Excel – Aneksi 5),
- Plotësimin dhe nënshkrimin e Deklaratës së Pranueshmërisë (Formati në Word – Aneksi 6),
- Lista e kontrollit (Formati në Word – Aneksi 7)

- Kopjen e Raportit Financiar final të vitit të paraprak (bilancin dhe të hyrat) e certifikuar nga një agjenci për operacione financiare dhe financier licencuar dhe certifikuar, përveç nëse organizata është themeluar në këtë vit,

Në rast se projekti aprovet, mund të kërkohen dokumentet origjinale.

5. Kush mund të aplikojë?

Pjesëmarrja në këtë thirrje për propozime është e hapur për të gjithë mbi baza të barabarta, për OSHC-të dhe OJQ-të (shoqatat apo fondacionet) të regjistruara zyrtarisht në Ballkanin Perëndimor (Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi) dhe në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Me qëllim që të aplikojë në thirrjen për propozime aplikanti duhet:

- Të jetë entitet i regjistruar joprofitimprurës në Ballkanin Perëndimor (Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi), në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi (shoqatat apo fondacionet).

Aplikantët potencialë **nuk mund të marrin pjesë** në thirrje apo nuk do të marrin grante përderisa ata nuk e dorëzojnë të nënshkruar **Deklaratën e pranueshmërisë** (Aneksi 6) me projekt propozimin.

Aplikantët do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje apo nga alokimi i grantit nëse në çfarëdo kohe të dorëzimit të projekt propozimit:

- (a) janë subjekt i konfliktit të interesit;
- (b) janë fajtorë për ofrimin e informacionit fals të një pale e autorizuar kontraktuale, të cilat kërkohen si parakusht për pjesëmarrje në thirrje për dorëzimin e projekt propozimeve apo nëse ata dështojnë të dorëzojnë informacionin e kërkuar;
- (c) u përpoqën të marrin informata konfidenciale, ushtrojnë ndikim mbi Komisionin Vlerësues apo palën e autorizuar kontraktuale gjatë procesit të vlerësimit të projekt propozimeve.

6. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e projekteve mund të jetë në mes të 4 dhe 6 muaj, dhe projektet duhet të zbatohen gjatë periudhës në mes të 01/12/2018 dhe 31/05/2019. Aktivitete që kanë ndodhur para kësaj date nuk mund të financohen.

7. Lokacionet

Projektet duhet të zbatohen në vendet përfituese të IPA në Ballkanin Perëndimor (Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi). Me përjashtime, disa projekte mund të realizohen edhe jashtë regjionit, nëse ato kontribuojnë në qëllimet e projektit. Për shembull, prezantimi i projektit në Parlamentin Evropian, apo aktivitete tjera të cilat duhet të realizohen jashtë regjionit.

8. Llojet e projekteve

Projektet që do të financohen duhet të përgatiten në pajtim me thirrjen për propozime dhe objektivat specifike që ato përmbajnë.

Projektet duhet të ofrojnë zgjidhje për nevojat specifike të komunitetit lokal dhe target grupeve të identifikuar nga projekti.

Projektet duhet të konsistojnë nga aktivitete operationale të pavarura me qëllime operationale të përcaktuara qartë, target grupe dhe rezultate të planifikuara.

Projektet duhet të jenë një strukturë e integruar metodologjike e aktiviteteve, e krijuar për të arritur qëllime të caktuara dhe rezultate specifike Brenda një afati të kufizuar kohor.

Plani i përgjithshëm i punës së aplikantit apo partnerit të projektit nuk mund ta përfaqëson projektin.

Aktivitetet e mundshme mund të përfshijnë:

- Aktivitete të drejtpërdrejta avokuese
- Huluntim nga zyra
- Studime bazë
- Lehtësimin e kontakteve, konsultime dhe diskutime në mes të hisedarëve të ndryshëm

- Aktivitete të komunikimit dhe informimit që kanë për qëllim mbështetjen e konsultimeve me hisedarë
 - Organizimin e konferencave, tryezave të rrumbullakëta, punëtorive dhe seminareve
 - Avokim për rishikim të legjislacionit ekzistues dhe adoptim të legjislacionit të ri në pajtim me standardet dhe kërkesat e BE
 - Vendosjen e dialogut me partitë politike, grupet parlamentare apo trupat legjislativ
 - Draftimin e rekomandimeve për politika apo legjislacion
 - Kampanja për rritje të vetëdijes publike
 - Publikimin e fletushkave, doracakëve mbi praktikatat e mira
 - Artikuj në media, kampanja dhe seriale programore.

Aktivitetet në vijim nuk rekomandohen për alokim të granteve:

- aktivitete të lidhura vetëm apo kryesisht me sponsorime individuale për pjesëmarrje në punëtori, seminare, konferenca, kongrese;
- aktivitete të lidhura vetëm apo kryesisht me bursa individuale për studime apo kurse trajnimi;
- aktivitete që promovojnë promovim të aktiviteteve tregtare;
- konferenca “one-off”, dhe ngjarje të ngjashme;
- aktivitete të lidhura vetëm apo kryesisht me hulumtime akademike dhe/apo studime të fizibilitetit;
- aktivitete që përfshijnë aktivitete të krijimit të granteve (p.sh. përdorimin e fondeve për të ofruar grante apo hua për organizatat tjera);
- aktivitete të lidhura vetëm apo kryesisht me investime infrastrukturore dhe/apo prokurimin e pajisjeve;
- aktivitete të lidhura me partitë politike apo të natyrës politike/partiake;
- aktivitete që kanë të bëjnë me ndihma emergjente apo donacione bamirësie;
- aktivitete të cilat bien Brenda aktiviteteve të përgjithshme të komponentave të institucioneve shtetërore apo shërbime të administratës shtetërore, duke përfshirë qeverinë lokale;
- aktivitete që lidhen me:
 - industrinë e duhanit (CAEN kodi 16)
 - prodhimi i pijeve të destiluara alkoolike (CAEN kodi 1591)
 - armatim dhe municione (CAEN kodi 296).

9. Dukshmëria

Vini re se aplikanti duhet ti përmbahet objektivave dhe prioriteteve dhe të garanton dukshmëri të financimit të BE-së (shiko Manualin për Komunikim dhe Dukshmëri për projektet e jashtme të BE-së e formuluar dhe publikuar nga Komisioni Evropian në (shiko http://ec.europa.eu/europeaid/work/visibility/index_en.htm).

10. Numri i projekt propozimeve dhe granteve për aplikant

Një aplikant mund të aplikojë vetëm me një propozim.

11. Ku dhe si të merret dhe dorëzohet materiali për aplikim

Informacioni përkatës, gjithashtu një version elektronik i tërë pakos së aplikacionit mund të merret gjithashtu nga: <http://wings-of-hope.ba/balkan-monitoring-public-finance/public-call-for-csosngos-in-the-field-of-public-finances>

Aplikantët duhet t'i dorëzojnë aplikacionet në gjuhën amtare. Aplikacioni konsiston në formularin e aplikacionit dhe formën e buxhetit të ofruara nën këtë thirrje dhe dokumentacionin shtesë të listuar nën 4.

Aplikacionet e kompletuara, me të gjitha dokumentet mandatore duhet të dërgohen përmes postës elektronike tek: diellza.salihu@birn.eu.com Në titull, duhet të konstatohet si vijon: Projekt propozim nën thirrjen “BMPF”.

Çdo aplikant i cili ka dorëzuar një projekt në kohë do të marrë faturat përkatëse.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është e enjte, 1 nëntor në ora 12:00.

Aplikacionet e dërguara me mjete tjera (p.sh. me faks apo postë) apo e dërguar në ndonjë adresë tjetër nuk do të merret në konsideratë.

12. Informacion shtesë

Nëse lind nevoja, do të organizohen takime informative për thirrjen për propozime me aplikantët potencial (“ditët e hapura”) gjatë kohës sa thirrja është e hapur.

Në këto takime, aplikantët potencial do të informohen në detaje rreth thirrjes, mënyrës së aplikimit, kriteret, etj.

Nëse kërkohet ndonjë informacion apo sqarim shtesë, kandidatët potencial mund të dërgojnë një kërkesë me reference për Aplikantët për Thirrjen për Propozime tek adresa elektronike: diellza.salihu@birn.eu.com Pyetjet mund të dorëzohen deri më **19/tetor/2018**, dhe përgjigjet do të ofrohen me shkrim brenda 5 ditëve pune nga data e pranimit të pyetjeve respektive. Për qëllime transparence, përgjigjet gjithashtu do të publikohen në web faqen e projektit.

13. Vlerësimi dhe seleksionimi i projekt propozimeve

Aplikacionet do të konsiderohen dhe vlerësohen nga ekipi i projektit “OSHC-të si partner i barabartë në monitorimin e financave publike” me mbështetjen e mundshme nga vlerësues të jashtëm. Të gjitha projektet e dorëzuara nga aplikantët do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve vijuese:

Nëse vlerësimi i aplikacionit zbulon se projekti i propozuar nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë, projekti do të refuzohet vetëm mbi këtë bazë.

(1) Kushtet administrative:

- Aplikacioni ka qenë i dorëzuar përmes postës elektronike dhe afati i dorëzimit është respektuar. Nëse afati nuk është respektuar aplikacioni do të refuzohet automatikisht.
- Aplikacioni i plotëson të gjitha kriteret e specifikuar në pikat e Listës së kontrollit në formularin e aplikimit për grant. Nëse ndonjë prej informacioneve të kërkuara mungon apo nuk është i saktë, aplikacioni mund të refuzohet vetëm mbi këtë bazë dhe aplikacioni nuk do të vlerësohet më tutje.

(2) Kushtet lidhur me aplikantin dhe aktivitetet:

- Konfirmimi se aplikanti dhe aktivitetet i plotësojnë kushtet e vëna në kapitullin 5, 6, 7, 8 dhe 10.

(3) Vlerësimi i cilësisë së projektit dhe vlerësimi financiar:

Vlerësimi i cilësisë së projektit, duke përfshirë edhe buxhetin e propozuar, do të kryhet në pajtim me kriteret e vëna në tabelën e vlerësimit të prezantuar në faqe 12 të këtij dokumenti. Ka dy lloje të kriterëve të vlerësimit: kriteri i seleksionimit dhe kriteri i alokimit të fondeve.

Qëllimi i kriterëve të seleksionimit është të ndihmon në vlerësimin e kapaciteteve financiare dhe operacionale të aplikantit me qëllim që të sigurohet se ata:

- kanë fonde të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për punën e tyre gjatë tërë periudhës së zbatimit të projektit;
- posedojnë kapacitete profesionale dhe kualifikimin e nevojshëm për zbatim të suksesshëm të projektit. Kjo gjithashtu zbatohet për partnerët e aplikantit.

Alokimi i fondeve siguron që cilësia e projektit të dorëzuar është vlerësuar në bazë të fushave të përcaktuara prioritare dhe se fondet janë aprovuar mbi bazë të aktiviteteve të cilat maksimalizojnë ndikimin e përgjithshëm të thirrjes për propozime. Kriteret i referohen rëndësisë së projektit të propozuar, për afrimi i projektit me qëllimin e thirrjes për propozime dhe fushat prioritare, cilësinë e projektit, rezultatet e pritura, qëndrueshmërinë e projektit dhe efektivitetin e kostos së fondeve të kërkuara.

Ju lutemi kushtoni rëndësi informacionit të rëndësishëm vijues:

Sistemi i vlerësimit (pikët):

Kriteri i vlerësimit është i ndarë në dy seksione dhe nën seksione. **Secili nën seksion duhet të vlerësohet me pikë të caktuara në mes të 1 dhe 5 në mënyrën si vijon: 1 = shumë keq; 2 = keq; 3 = i duhur; 4 = i mirë; 5 = shumë i mirë.** Secili anëtar i komisionit plotëson një tabelë vlerësimi individuale, dhe të gjithë anëtarët e nënshkruajnë tabelën e vlerësimit përmbljedhës për secilin projekt propozim. Renditja e projekt propozimeve bëhet në atë mënyrë që projekt propozimi i parë i renditur është ai me pikët më të larta, i pasuar nga projekt propozimi me më pak pikë, deri tek projekt propozimi me pikët më të ulëta.

Vetëm projektet me pikë prej 50 apo më tepër do të merren për konsiderim të mëtejshëm, pasi propozimet më poshtë këtij pragu nuk kanë përbushur standardet, duke vënë në pyetje efikasitetin e aftësisë së tyre për zbatim.

Me qëllim që të merren në konsiderim për financim, projektet me buxhete mbi 7,000 EUR duhet të marrin 75 apo më tepër pikë gjatë procesit të vlerësimit. Vendimi për aprovim të grantit bazohet në totalin e numrit të projekteve të cilat mund të financohen brenda fondeve në dispozicion. Këto limite

janë vendosur për të përcaktuar minimumin e cilësisë së projekteve të propozuara dhe për të siguruar vlerën më të mirë monetare. Projektet me vlerësimin më të lartë do të kenë prioritetin në marrjen e grantit.

Shënim mbi Seksionin 1. Kapaciteti financiar dhe operacional i aplikantit

Në rast se totali i pikëve në Seksionin 1 është më i ulët se 10 pikë, projekti do të përjashtohet nga procesi i mëtutjeshëm i vlerësimit, pasi që organizata nuk e ka minimumin e kapaciteteve për të siguruar zbatim cilësor të projektit të propozuar.

Shënim mbi Seksionin 2. Relevanca

Në rast se totali i pikëve në Seksionin 2 është më i ulët se sa 18 pikë, projekti do të përjashtohet nga konsiderimi i mëtejshëm pasi që pikët nënkuptojnë që, ndonëse aplikanti i përmbush kapacitetet financiare dhe operacionale, koncepti i projektit nuk është relevant apo në linjë me prioritetet e përcaktuara të thirrjes; projekti nuk adreson nevojat e komunitetit lokal.

Tabela e vlerësimit

Seksioni	Maksimumi i pikëve	Pikët mesatare
1. Kapaciteti financiar dhe operacional	15	
1.1 A janë aplikanti dhe partnerët me përvojën e mjaftueshme në menaxhim të projekteve?	5	
1.2 A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën relevante)	5	
1.3. A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme menaxheriale? (duke përfshirë stafin, pajisjet dhe kapacitetet për menaxhim financiar)?	5	
2. Relevanca	25	
2.1. Sa relevant është projekti në krahasim me qëllimin dhe një apo më tepër prioritete të përcaktuara nga thirrja? Shënim: 5 pikë (shumë mirë) mund të caktohet vetëm nëse projekt adreson së paku një nga prioritetet.	5	
2.2 A janë hisedarët të përcaktuar qartë dhe të përzgjedhur në mënyrë strategjike (agjent, përfituesit final, target grupet)?	5	
2.3 A janë nevojat e target grupit dhe përfituesit final të përcaktuar qartë dhe se projekti i adreson në mënyrën e duhur?	5	
2.4 A inkorporon projekti vlerë të shtuar , si qasja inovative dhe modelet e praktikave të mira?	5	

2.5 A avokon projekt propozimi për qasjen e bazuar drejtë dhe a ndikon te grupet e cenueshme? (Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, mbrojtja e ambientit, bashkëpunimi ndërkombëtar, të rinjtë, etj.).	5	
3. Metodologjia	20	
3.1 A korrespondojnë plani i aktiviteteve dhe aktivitetet e propozuara logjikisht dhe praktikisht me qëllimet dhe rezultatet e pritura?	5	
3.2 Sa konsistent është dizajni i përgjithshëm i projektit? (veçanërisht, a reflekton ai analizën e identifikimit të problemeve, faktorëve të mundshëm të jashtëm)	5	
3.3 A është niveli i angazhimit të partnerëve të projektit i kënaqshëm? Shënim: nëse nuk ka partner, vlerësimi me pikë do të jetë 1 .	5	
3.4 A janë të përfshirë indiktorët e matshëm objektivisht në projekt?	5	
4. Qëndrueshmëria	25	
4.1 A do të kenë aktivitetet e propozuara ndikim konkret mbi target grupet?	5	
4.2 A do të ketë projekti ndikim të shumëfishtë? (duke përfshirë mundësinë për aplikim tek target grupe tjera apo zbatim në lokacione tjera dhe/apo shtrirje të ndikimit të aktiviteteve dhe gjithashtu këmbim të informacionit mbi përvojën e fituar përmes zbatimit të projektit)	5	
4.3 A janë rezultatet e pritura të aktiviteteve të sugjeruara institucionalisht të qëndrueshme? (a do të ekzistojnë strukturat e mundësuar nga aktivitetet e projektit pas përfundimit të projektit? A do të ketë një pronësi lokale mbi rezultatet e projektit?)	5	
4.4 A janë rezultatet e pritura të qëndrueshme? (nëse janë të aplikueshme, emërto ndikimin strukturor të aktiviteteve të zbatuara – përmirësimet e kornizës ligjore, metodat, kodi i mirësjelljes, etj..)	5	
4.5 A ka gjasë që rezultatet/të dalat afat gjata do të ndikojnë kushtet ekonomike lokale dhe/apo cilësinë e jetës së zonave të targetuara?	5	
5. Buxheti dhe efektiviteti i kostos	15	
5.1 A është raporti në mes të kostove të vlerësuara dhe rezultateve të pritura i kënaqshëm?	5	
5.2 A janë kostot e sugjeruara të nevojshme për zbatimin e projektit?	5	
5.3 Buxheti - a është buxheti i qartë dhe a përfshin pjesën narrative? (duke përfshirë sqarimet për pajisjet teknike) - përmbush parimin se shpenzimet administrative dhe kostot e personelit nuk mund të jenë mbi 40% të totalit të buxhetit?	5	

- a janë përfshirë CV-të dhe përshkrimi i punës aty ku është e aplikueshme?		
Maksimumi i pikëve totale	100	

Pas vlerësimit, do të përpilohet një tabelë e cila liston aplikacionet e ranguar sipas pikëve dhe brenda zarfit financiar në dispozicion, gjithashtu edhe një listë rezervë duke ndjekur të njëjtat kritere.

14. Njoftimi për vendim

Të gjithë aplikantët, pa marrë parasysh nëse aplikacionet e tyre janë aprovuar për financim apo refuzuar, do të njoftohen me shkrim për vendimin mbi projekt propozimin e tyre brenda 24 ditëve nga mbyllja e thirrjes. Rezultatet do të publikohen në web faqen e projektit <http://wings-of-hope.ba/balkan-monitoring-public-finance/public-call-for-csos/ngos-in-the-field-of-public-finances>.

Një vendim për ta refuzuar një projekt propozim apo mohuar fondet do të bëhet nëse:

- Aplikanti nuk i plotëson kushtet e thirrjes për propozime;
- Aktivitetet e projektit janë të papranueshme (p.sh. aktivitetet e propozuara shkojnë përtej qëllimit të thirrjes për propozime, kohëzgjatja e paracaktuar e projektit tejkalon maksimumin e lejuar të periudhës kohore, shuma e kërkuar e fondeve tejkalon shumën maksimale të lejuar apo është më e ulët se sa minimumi, etj.);
- Projekt propozimi nuk ishte mjaftueshëm relevant; kapacitetet financiare dhe operationale të aplikantit nuk janë të mjaftueshme, apo projektet e seleksionuara për financim kanë qenë superiore në këto fusha;
- Cilësia e projekt propozimit ishte teknikisht dhe financiarisht më e ulët në krahasim e projektet e seleksionuara për financim.

15. Kushtet lidhur me zbatimin e projektit pas aprovimit të grantit

Pas marrjes së një vendimi mbi aprovimin e grantit, organizata joqeveritare të cilës i është aprovuar projekti do t'i ofrohet një kontratë për zbatim të projektit. Para nënshkrimit të kontratës dhe nëse nevojitet, projekti mund të kërkohej të pëson ndryshime të caktuara, me qëllim që të jetë në përputhje me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit.

16. Tabela e afateve kohore

	Date	Time
--	-------------	-------------

Afati i fundit për kërkim të sqarimeve nga projekti BMPF	19/10/2018	12.00
Data e fundit ku do të ofrohen sqarimet nga projekti BMPF (në http://wings-of-hope.ba/balkan-monitoring-public-finance/public-call-for-csos/ngos-in-the-field-of-public-finances)	24/10/2018	-
Afati i fundit për dorëzimin e Aplikacioneve	1/11/2018	12.00
Informimi i aplikantëve mbi vlerësimin e Aplikacioneve	24/11/2018	-

Kjo tabelë kohore mund të freskohet me informacione nga projekti gjatë procedurës. Nëse po, tabela e freskuar me informacione do të publikohet ne web sajtin e projektit <http://wings-of-hope.ba/balkan-monitoring-public-finance/public-call-for-csos/ngos-in-the-field-of-public-finances> dhe faqen e Facebook të projektit (Balkan Monitoring Public Finances).

LISTA E ANEKSEVE

- Aneksi 1** Projekt Propozimi
- Aneksi 2** Buxheti
- Aneksi 4** Forma Administrative e Identifikimit
- Annex 5** Forma Financiare e Identifikimit
- Aneksi 6** Deklarata e Pranueshmërisë
- Aneksi 7** Lista e Kontrollit